

Analiza vjetore 2019

Departamenti i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit

Në datën 30 Janar 2019, Departamenti i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit në zbatim të urdhrorit nr. 6, datë 23.01.2020 të Kryetarit të KLSH, “Për kryerjen e analizës vjetore të veprimtarisë së departamenteve të KLSH-së për vitin 2019” ka zhvilluar në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në sallën “**Gene Dodaro**”, analizën vjetore të vitit 2019, duke u fokusuar në këto drejtime:

- Analizë statistikore mbi aktivitetin e Departamenti për vitin 2019;
- Analizën e dy auditimeve më të mira;
- Analizën e dy auditimeve më të dobëta;
- Problematika të evidentuara nga Raportet e sigurimit të cilësisë;
- Diskutimet e dy botimeve të KLSH-së të vitit 2019;
- Konkluzionet e analizës;

Pjesëmarrës në këtë analizë, përveç drejtuesve dhe audituesve të departamentit, ishin edhe Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit z. Bujar Leskaj dhe Drejtori i Përgjithshëm, z. Rinald Muça si përfaqësues të mediave të ndryshme.



Në fjalën e hapjes e Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit z. Bujar Leskaj përgëzoi Departamentin për arritjet në rrugëtimin e tij të shkurtër, veç 4 vite më parë ai theksoi se “Sfida e institucionit do të jetë Auditimi i Teknologjisë së Informacionit”.

Si çdo departament i ri dhe në veçanti për rëndësinë që ka në këto vite struktura TI dhe procesi i dixhitalizimit në KLSH, mendoj që ju nuk duhet të kënaqeni me çfarë keni arritur dhe puna e departamentit tuaj duhet të reflektohet në të gjitha departamentet e tjera të KLSH-së.

Ka ardhur koha, të synojmë që elemente të teknologjisë së informacionit, bazuar mbi standartet apo metodat më të mira të TI-së duhet të shfrytëzohen e përfshihen në të gjitha auditimet e departamenteve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Ju ashtu siç ishit pionierë në auditimin TI në fillimet e viteve 2014-2015 duhet të kaloni tashmë në rolin e liderit.

Në vijim, drejtori i departamentit z. Kozma Kondakçiu, paraqiti një raport analizë statistikore mbi veprimtarinë e Departamentit për vitin 2019 e arritjet e departamentit në përputhje të përmbushjes së objektivave institucionale që parashtron Strategjia 2018-2022 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit.

Sipas programit vjetor të auditimit për vitin 2019, Departamenti ka pasur si objektiv realizimin dhe evadimin e 7 auditimeve nga 6 të tilla të planifikuara e realizuara një vit më parë, objektiv

të cilin e kemi realizuar 100%. Risi për këtë vit është rritja me mbulimit me auditim të subjekteve realizuar 17 subjekteve nga 6 të një viti më parë.

- Zhvillimin e burimeve njerëzore për Auditimin IT një sfidë jo vetëm e KLSH-së e kemi realizuar në mënyrë ambicioze duke kryer rekrutimin e 5 audituesve të rinj përgjatë vitit 2019 sidhe zhvillimit profesional të audituesve të Departamentit nëpërmjet realizuar mesatarisht 49 ditë trajnim për çdo auditues.

Audituesit e Departamentit kanë marrë pjesë në zhvillimin e kolanës së botimeve të KLSH-së duke dhënë asistencën teknike në 40% të botimeve të vitit 2019.

Në vazhdim fjalën e mori Drejtori i Përgjithshëm z. Rinald Muça, e cila ndër të tjera vendosi theksin në objektivat dhe sfidat që na presin në vitin 2020, në veçanti në kryerjen e auditimeve cilësore it si dhe duke vene ne dukje ngjashmërinë e auditimit it me atë te performances kërkoi rritjen e bashkëpunimit me auditime te përbashkëta me departamentin e performances.

Në vazhdim të fjalës se tij z. Muca vuri theksin në rritjen e Publikimit dhe komunikimit të produkteve të auditimit, për këtë qëllim duhet të përdoren të gjitha kanalet duke mos lenë pas dore mediat sociale

Aktiviteti vijoi me prezantimet e dy prej auditimeve më te mira të cilat u prezantuan nga kryeaudituesi z. Benard Haka per auditimin e kryer ne subjektin Ministria e Financave dhe Ekonomise, znj. Elsona Papadhima për auditimin e kryer ne subjektin Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Nga Audituesit Bledi Dervishaj dhe Edlira Cukalla ne prezantimin e tyre mbi auditimet me te dobëta u theksua se sektori i cilësisë nuk ka klasifikuar auditime te dobëta per vitin 2019 për departamentin e Auditimit IT Në vijim ata paraqiten disa dobësi te vërejtura në auditimet e kryera dhe masat që duhet të kihen parasysh për përmirësimin e cilësisë së auditime TI.

Prezantimi i dy nga botimeve te KLSH për vitin 2019 u paraqit nga Përgjegjësi sektorit IT z. Aldo Kita për botimin “Rregullorja e Procedurave të Auditimit & Rregullorja e Sistemit të Menaxhimit të Proceseve” dhe audituesi z. Rodjan Alimerko për botimin “Young ALSAI 2019” Sfidat e auditimit publik në kontekstin e anëtarësimit të vendit në BE.

Probleme të planifikimit të vërejtura gjatë vitit 2019 në përdorimin e analizës së riskut me manualit aktiv të auditimit TI të evidentuara në një analizë statistikore të paraqitur nga drejtori i departamentit qe pjesë e diskutimeve për evidentimin e dobësive dhe përmirësimin e punës në të ardhmen.

Në përfundim, drejtori i departamentit, z. Kozma Kondakciu, prezantoi objektivat kryesorë të Departamentit të Auditimit TI për vitin 2020, ndër të cilat planin e auditimeve për vitin 2020 ne te cilin është parashikuar një rritje prej 43% e numrit te auditimeve, si dhe objektivat kryesore qe duhet te përmbushen për realizimin e planit dhe te veprimtarisë audituese për vitin 2020.

Objektivi kryesor i Departamentit të Auditimit të TI është zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve të auditimit të sistemeve TI, Përhapja e shpejtë e teknologjisë kompjuterike dhe përdorimi i “Big Data” në auditim kërkojnë përdorimin e mjeteve vizualizuese dhe analizuese, auditues të TI të aftë, të mirë trajnuar dhe që zotërojnë dijet e duhura

Në funksion të objektivit kryesor, Departamenti duhet të thellojë më tej punën në këto drejtime: Së pari: Përvetësimi dhe përdorimi në auditim i teknikave CAAT, IDEA, COBIT, si dhe thellimi i njohurive në fushën e teknologjisë se informacionit.

Së dyti: Pajisja e audituesve IT me çertifikata të fushës, të njohura ndërkombëtarisht.

Së treti: Përmirësimin e planifikimit të Auditimit nëpërmjet përvetësimit më të mirë të manualit aktiv të auditimit.